

FESTIVALI I KRIJIMIT LETRAR 2017-2019



*Koha në gjilpërën prej pambuku
Jeromë
Si gruri do të digjem fushës
Rranja (Monolog i nji njeriu t'papërsosun)
Firë
Dy ditë
Ti, pastaj unë
Lupa e shikimit të fajit
Humnerë e bardhë
Përshkrim
Puhizë njerëzore
Pnevamotoforë
Klepsidra
Tregoj
Rrugënjë në perëndim*



FESTIVALI I KRIJIMIT LETRAR

2017-'19

~ PËRZGJEDHJE ~



PARAFJALË

1.

Festivali i krijimit letrar është pjesë e pandarë e veprimtarive të Departamentit të Letërsisë, në *Ditën Botërore të Librit dhe të së Drejtës së Autorit*, që mbahen çdo vit, më 23 Prill. I ideuar dhe i organizuar nga vetë studentët, nën kujdesin e pedagogeve e poetëve prof.asoc.dr. Viola Isufaj dhe dr. Belfjore Qose, ai përshfaq shpirtin krijues të studentëve në komunikim artistik të përbashkët, si dëshmi e përvojë e kreativitetit dhe talentit të tyre e si pjesë e traditës së studentëve të Degës së Gjuhës e të Letërsisë Shqipe, të Universitetit të Tiranës, prej të cilëve kanë spikatur personalitete të dijes albanologjike, studiues të mirënjohur të letërsisë, mësues të përkushtuar, shkrimtarë e poetë të shquar.

Në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Librit dhe të Leximit, që synon edhe inkurajimin e autorëve të rinj e nën përkujdesjen e drejtores së saj, znj. Alda Bardhyli, botimi i përzgjedhjes së prurjeve të Festivalit të Krijimit Letrar, 2017-`19, vjen në këto kohë të pazakonta për të gjithë; ai frymon fuqinë e fjalës artistike kundër izolimit, mpak distancimin social ndërmjet nesh, duke na përcjellë dashurinë për letërsinë e leximin përmes udhëtimit imagjinar nga jeta e përditshme e studentëve, te raportet e tyre intime, nga shqetësimet sociale të vërejtura me sy kritik, te pyetjet e mëdyshjet individuale në rrafsh meditativ e filozofik.

Përgëzoj autorët e rinj, e besoj që ky botim të ndiqet nga të tjerë për të vijuar traditën, që i takon studentëve të letrave të bukura, në publikimin e krijimeve të tyre.

*Përgjegjëse e Departamentit
Prof.asoc.dr. Lili Sula*

2.

Mbase kurrë nuk do ta dimë përse një shprehje e caktuar, që në rrafshin material tregon përgjysmim (mase, distance a force), p.sh., “gjysmë hënë larg”, në terma të poezisë ka dyfish më shumë forcë sesa “një hënë larg”, duke e bërë gjysmën të jetë më e fuqishme se e plota. Nuk e dimë, mbase asnjëherë s’do ta dimë arsyen. Dhe nuk do të vijojmë më tej, sepse mund të ndihemi papritmas ligisht, në këto përpjekje për zbulim. Na mbetet të dimë që pak mund të jetë shumë dhe shumë mund të jetë pak.

Asnjë poeti të madh, me talent autentik, asnjë dashuruesi metaforash a njohësi të thellë të origjinave të kulturës, etikës e metafizikës apo gjendjeve njerëzore, me aq sa njihet, nuk i ka gënjer mendja ndonjëherë të marrë përsipër të na sqarojë enigmën e poezisë. Ata, megjithatë, kanë dhënë e kanë marrë me këtë të fshehtë. E ndoshta të gjithë shpirtrat subtilë e plot sensibilitet, janë duke komunikuar me atë mister. Studentët tanë vijnë këtu me të tilla përpjekje për komunikime, dhënie dhe marrje me enigmën e poezisë – përfaqësuar nga krijimet me të cilat morën pjesë në festivalet që organizon Departamenti ynë prej vitesh, më 23 Prill. Është dhe ka qenë ky, një lloj kremtimi, shprehje e dashurisë për letërsinë, kënaqësisë së leximit dhe e mirënjohjes për rolin e pamatë të librit në përcjelljen e trashëgimisë kulturore.

Ky botim bën bashkë disa prej krijimeve letrare të studentëve ndër vite, të prezantuara në festivalet tona letrare, me dëshirën për t’u sjellë një të papritur të bukur atyre, në kohën kur një epidemi globale ka mbërthyer tri të katërtat e globit dhe kur bota mbarë po përjeton një mbyllje tërësore dhe vetmitare.

Shí në këtë rrethanë dramatike dhe surreale janë tridhjetë e shtatë gjuhë shpirtrash që na përshëndesin sot; e pa asnjë dyshim, në çdo kohë e rrethanë letërsia flet...

Prof.asoc.dr. Viola Isufaj

3.

Kur Roberto Bolanjo deklaroi se “të lexuarit ka më shumë rëndësi se të shkruarit”, hapi një debat të qenësishëm për rëndësinë e dy proceseve të pandashme që jetësojnë veprën letrare, edhe pse sot me humor mund të themi se vetë autori i kësaj thënieje ndoshta ka dashur që të gjithë të lexojmë veprat e tij. Botimi i pjesëve të Festivalit të Krijimit Letrar është një përmbledhje e krijimeve të studentëve që ndjekin studimet për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, studentë, jeta universitare e të cilëve është e mbushur me lexime veprash letrare, analiza, leksione, seminare dhe shumë punë me interpretimin e librave... të të tjerëve. Rrallëherë i pyesim studentët tanë: Po ata vetë a shkruajnë? Nëse shkruajnë, a kanë vlerë krijimet e tyre përtej personale, a mund të përmirësojnë veten, të shkruarit, të kërkojnë novatorizëm apo forma të reja? Të gjitha këto procese kanë nevojë për komunikim disapalësh, mes tyre vetë, profesorëve, krijuesve me përvojë; një komunikim që realizohet vetëm me botimin e krijimeve të tyre. Botimi i kësaj përmbledhjeje është një rast për të cilin gëzohemi si profesorë të tyre, por edhe si krijues, pasi e njohim emocionin e publikimeve të hershme. Sigurisht, që disa prej studentëve në të ardhmen do shkruajnë në mënyrë më të përpunuar, më të stilizuar dhe siç ndodh shpesh me krijuesit, ndoshta do të skuqen nga mënyra se si kanë shkruar vite më parë, por në këtë skuqje do ketë me siguri pakëz nga drithërima e botimit për herë të parë, hapjes së parë të dritares së komunikimit artistik me të tjerët.

Ne jemi të bindur se në këtë botim ka krijues, emrat e të cilëve në të ardhmen do të jenë ndër autorët më të mirë të letërsisë shqipe.

Dr. Belfjore Qose

POEZI

Firë

E pashë
Dheu u hap para syve të mi
U mbollën ndoca rrënjë lulesh
Që kacavirren s' di se ku.

I dëgjova
Gjethet tek fëshfërijnë në trupin tim
E madje
Në flokët e mi një degëz
U shtri si një lehonë
*

Pritmi gishtat
E mbillmi
Kanë për t' u bërë krahë
E kanë për të t' rrokur
Të tërin
Aty ku je.

Ku je?
Ku ishe?
Përgjigjmu!
Sepse,
Shpirti im mbahet ngushtë tek ti,
Ty të dëshiron mishi im në tokë të tharë
Dhe të djegur, pa ujë.

Lus

Si fëmija që mëndet nga nëna në gji

Pikë, pikë, pikë...

Një pikë.

*

E rrumbull qeshë, si gjiri që më mëkoi!!!

*

Mes mijërash fluturash

Cila vjen si ti?

Cili je ti?

E bardha, e mishta, e muzgëta?

Cila?

Firë bëhesh sa herë t'i zë ngoje.

Rrokur jemi

Në fotografinë tonë të vjetër

Të grisur tashmë

Në gjashtëdhjetë copa.

Ke për të thënë

Ma harrove datën e lindjes

Ah,

Zoti e dashtë!

*

Ka kaq shumë njerëz

Kaq shumë

Njerëz

Sa shumë!

Jeromë

Të gjitha pemët kanë ndryshuar emër.
Jeromë! Dëbomë jashtë!
Heshtja s'është më e njëjtë,
Aq më tepër ne!
Qelqet e rrugës ma vranë kurmin
E u bënë faltorja ime.
Përtej largësisë së përkulshme,
Përtej çdo misticizmi, Jeromë
Përtej çdo profanizmi,
S'njihja veçse gjuhën e duarve të mia
Që u krodhën në të tuat.
Nga imja natë e përzishme në tënden,
Nga thellësia e syve të tu
Në prarimin e brigjeve të mia.
Atëherë, Jeromë,
Kaq lumturisht,
Çdo pemë, çdo amorf
Shpërbëhet...

Rranja

(Monolog i nji njeriu t'papërsosun)

Askush t'mos m'thotë ku mshifet rrânja,
qi do t'rrisë kërcellin e jeshiltë!!!

Un' do gërmoj,

me thonj,

me thonj...

e kam për ta gjet...

Mbaj mbi supe peshën e njiqind syve,

n'kokë tingujt zhurmues t'grarisë (...)

n'gjoks...

(...heshtja e dashnisë...)

Akush t'mos m'thotë ku mshifet rrânja,

qi do t'rrisë kërcellin e jeshiltë...

Ju jeni msù me in shkul rrânjët,

me mjell para kërcellin

e me pâ si lshon rrânjë...

Por...

I kam pâ edhe kërcellet e juja...

jan'

kput

n't'parën

erë

dimni,

ose kan' ngel n'kâmë...

t'jeshilta jashtë

e t'kalbme

n'rrânjë...(((!!!)))

* * *

Në sa vargje të shkruaj për ty?
 Më lejon të shkarravis në to e t'i zhduk sërish?
 Më lejon t'i shkruajnë lotët,
 e t'i gropos nën dhé.
 Mos të shoh asgjë!
 Asgjë, që lidh dhe gllabëron me të varfrat kujtime shekullore.
 Asgjë që të mban kaq pas vetes duke mos besuar,
 se ti nuk je e ike.
 – Ike si zogjtë që fluturojnë larg e ti u zhduke nën re,
 ike si meloditë e pakontrolluara të një sonate të çmendur dedikuar një
 trishtimi që të gërvisht shpirtin
 e t'bën të qash, të ulërish, të humbasësh e të harrohesh,
 se s'paska më t'fortë, mallkuar qoftë, se dhimbja e humbjes!
 S'paska më të fortë se pesha e mallit, teksa të shtrydh mendimet,
 kujtimet, duke të pikuar gjak në shpirt.
 Duke dashur të të shihja, sytë s'bënin të shikonin.
 Duke dashur të vija e të shtrëngoja duart, s'mundesha se nuk isha unë
 e fortë.
 S'paska më të fortë, se humbja, harresa, malli që të çan shpirtin,
 e sytë të tradhtojnë.
 S'paska, asgjë më të fortë se boshllëku që ndjehet e ulërin.
 S'paska më të fortë se çdo fjalë e lënë pas.
 Po ku ike?
 A mundesh të kthehesh?
 Ç'të bëja?
 Ku asnjë lutje s'mundi të të mbajë pas vetes,
 ku asnjë fjalë s'mundi të të sjellë edhe një herë.
 E u shkëputën botët,
 nën mijëra lutje për t'u takuar, në një tjetër jetë!

Boll ma

Dhjetori im ish' ai i dritave të fikuna
n'lagështin e vetflijimit.
Për veten, për të gjith' 'to menime që vinin e
fishkeshin n'krye.
Dhjetori im ish' ai ku shpirti klithte
dhe zani heshtte, heshtte n'lot.
Heshtte n'dhimbje t'pashtershme, t'pajetueshme
midis jetës si kthetër e një zani të ftoht' e të idht'
si zani i vdekjes, e mos ka ma t'keq?
E më pas, ndije se ajo asht ndjesia që m'kaplon
damarët e m'duket sikur m'gushton e më merr
frymën çik nga çik!
Si ajo violina që i çjerr t'fundit tinguj n'ajër.
Dhjetori im vinte dhe përqeshte!
M'përqeshte dhe mbante dije:
- Hej, pa shih kush ka ardh'.
Mos ke menu se t'kam harru?!
Plaga e një buzqeshje t'vrame,
ma njolloste ftyrën, e kisha frikë.
E ndija se s'mund me shpëtu nga ky dhjetori im.
E ndija se m'grrynte, m'sakatonte krejt...
Ripërtërihesha për tu çjerr nga i fundit muj, ripërtërihesha,
dhe me një za t'dobt, një za t'mekun du me than boll ma!
Me një za t'fikun, boll ma!
S, i du ma dhjetorët, që m'kujtojnë përqeshjen e idht:
- Hej, jam ktu. Boll ma!

Dy ditë

I

Dita ngjason me batanijen që më heqin nga trupi,
Një dorë e tërheq dhe copëzat e mishit tim si mijëra xixëllonja,
shkojnë drejt fundit.
Dua që dora të më kalojë përtej fytit, dhe të nxjerrë prej aty
mushkëritë, mëlçinë, veshkat, zemrën dhe t'i rreshtojë përballë meje.
Tani peshoj më pak.
Dua ta derdh të gjithë gjakun tim,
mbi këpucët e vjetra që kam veshur kohë me radhë,
Kështu do të ikim bashkë.
Dua t'i shkul qerpikët me tufa
T'i shtrëngoij fort dhe më pas t'i shfryj si lule dëshirash,
Nën shtëpin' e ndotur shirash.

II

Ditë s'ka më. Prej kohësh mungon dhe nata, sepse qielli është ngrënë,
Vazhdimisht.
Të mërkurë, të martë, të hënë.
E di këtë, sepse unë e gëlltis, në një tas të vjetër plot me ujë dhe mel
Çapë
Çapë,
Ushqehem me qiell.

Si gruri do të digjem fushës

Mes pyllit krenar që mbet' qyqar
iu shtriva fushës.
Grurit të imët, kallinj të thekur
këputur kryet në erë,
tokës ia shtriu melodi e natgushtit.
Si gruri do të digjem fushës!
. . . Atij që furtunës i nxori gjoks
po mbi mua ra deg' e thyer.
. . . Atij që diellin ia hodhi fletëve,
e me ç' mund kalbi të njomat rrënjë.
Kur lagështira vjen peshqesh i gushtit,
i shtrihem fushës.
Kurritzit më shuajnë fletë tërfili
të shtypura dhe hapura përdhé.
Mbi degë kumbulle. . .
në bar një pullë. . . në grurë zhurë. . .

Porositë e Gjyshes

E vogla ime . . .
 Ka diçka që dua të t' tregoj,
 Ka bërë strehë në brendësi. . .
 Është strukur si të jetë fëmijë,
 Ku s'ka nevojë për fjalë e as për sy. . .
 S' dua të të gënjej me ndonjë përrallë
 s' mundem me ëndrra të t' gënjej
 qëkur linde e derisa t' jesh gjallë
 Jeta do të jetë fushë-betëjë.
 Shpresa të kota do të të shuajnë shpesh fuqinë,
 do t' ngjitesh mbi mure pengesash të vetëndërtuar,
 do t' rrëzohesh ashtu siç bën jeta me njerinë,
 shpresat shpeshherë do të kthehen thikë mbi duar. . .
 Pastaj plagët do të rrjedhin gjak,
 e kuqja mbi të bardhën mjellm' . . .
 nga sytë e tu do të dalin flak'
 jep dashuri, do të marrësh helm.
 Ç' do dhimbje do ta ketë një fund...
 se stinët ndërrohen padyshim,
 se gjethet e kalbura pema i shkund,
 s' mund të jetohet në mjerim.
 Do të marrësh shumë plagë në kraharor,
 aty do të mbijnë lule e do të lëshojnë aroma...
 nëse në shpirtin tënd ende do të ketë borë,
 kujto që s' është fundi akoma.
 Do t' vijë një moment që të gjithë do t' jenë larguar,
 dhe unë do të t' braktis një ditë, bija ime,
 Lotët thaji siç unë të kam mësuar
 s' do të jem më aty të t' i jap këto mësimë.

Vishe një maskë dhe buzëqesh,
fjalën e mirë t'ia thuash çdo njeriu,
Drita ime do të përhapet midis resh,
ashtu si del dielli pas shiu.
Për mua do të jesh një copëz pasqyrë,
do të shfaq tek ti mijëra reflektime
do t'jem shumë lart për t'më arrirë,
por do t'i them Qiellit:
Kjo është Bija Ime. . .

Gri

Ka lënë vrazhdën kërmilli endacak në parvazet që prekur kanë
dhenë,

Se qenë shtëpi sa gishti e shtatin hedhur s'kishin.

U shembën nga këmbë shumëkëmbëshi.

E tjegullat lotnë e kuq lëshuan.

Shi nuk ra, ta dini.

Vishnja e tyre, mendjemadhe në kohë ka varur gjithë krahët.

Ku ka trishtim më të madh se kaq?

Mos m'u përgjigjni.

Mbysni limontinë e kësaj kohe pa kohë.

Shpëtim mos kërkoni.

Puseve hidhni inatin e bashkë me të kovën dhe litarin.

Shkelni manat e bardhë në atë gjysmë oborri e kashtën që verës
mblodhët e harroni.

Ju them harrojeni.

Sa kanë vajtur ato shtëpi...

Mos rrini në vetmi.

Që kambanat të çmenden e të flenë të qetë ato që veten hanë.

Digjini kryqet se mëkatën të lirë lanë.

Rreth yjeve

Në qiell vërdallë
U sollën retë. . . u tjerrën.
Kur veten ngushtë e panë,
Yjet nga qielli ranë.
Kanë ftohtë. . .
Era jashtë po fryn,
Vetëm portën shtyn
E shpirtin ledhaton
Unë roje do të bëhem,
Gjumi s' më zë.
E sonte me engjëjt do të flas,
E ndihmë për këngën tënde
Do t' u kërkoj.
Të krijoj melodi
Me fëshfërima gjethesh
Nga gjumi të zgjoj vjeshtën
Që qëndron aty fshehur.
Era jashtë fryn
E vetëm portën shtyn
E unë roje do të bëhem
Me yjet në prehër qëndruar
Për vjeshtën e munduar.

Më duhet të iki

Më duhet të iki sonte
një lëmsh më mblidhet në gji
pas mbetet Devolli
i mjegullt, vallë do ta shoh përsëri?
Më duhet patjetër të iki sonte,
ashtu e lagur,
e endur nëpër shi...
Dhe s'i kuptoj këta lot të hidhur
i derdh syri, o' qiell, apo ti?
Si një endacak, varfanjak i fatit
vajzë e një përralle ndihem tani...
Të gjitha rrugët më çojnë në udhëkryqe
ku asnjëra s'ka tabelën "ti" ...
Nën daullet e shiut rendin gurët
nëpër sokakë si lepuj të murrme...
Në parvazin e dritares sime
s'do t'më gjejnë më yjet t'më qëllojnë me plumba
po iki pra, e ndoshta nesër
s'do t'më shihni bahçeve
natyrisht s'do të harrohem atje ku
do të jem shkruar në zemra ...

Ti, pastaj unë. . .

E di që zemra të merr flakërim
 Dhe fryma të zë fjalët nën gjuhë
 Ndaj dhemb shpirti
 Dhe ajo pak shpresë e mbijetuar
 Zë të shembet para syve
 Nuk e di
 Ndoshta ia arrite qëllimit
 Vodhe lirinë e fjalës
 Guximshëm
 Barbarisht
 Ndaj ngrije lart
 Një pëllëmbë mbi kokë,
 një arnë të verdhë
 Ta shfaqesh lirinë tënde sipër times
 Ndalove vargun që buronte lirshëm
 Të gjitha metaforat m'i helmive
 M'i theve, m'i shkele
 M'i dënove me vdekje
 E kur një ditë të ngrihet në shesh përmendore
 E dhimbjeve të mia
 Dhe sheshit lexohen vargjet e mia
 Mbi ato varre metaforash
 Stinët, ta dish mirë, stinët
 Asht e lëkurë do të mbesin
 Shtrirë dhe pa frymë

Aty ku epokë jona
Nuk mbetet dhimbje
Ndonëse këngë dhimbje
Ka të ngjarë. . .
Kur më ikë nata e më zbardh mëngjesi.

Net Krishtlindjesh

Sa herë jam përpjekur të prek honet e sfilitura
 Nga pagjumësia e netëve blu,
 Të mbaj në duar, palëvizshmëria ime e shformuar,
 I dehe flokët me melodinë e trishtimit të dimrit
 E prapë jeton e mekur,
 Rrëgjuar nga gjysmëfati i mëkuar me fjolla bore.
 Ti s'e di si festohen Krishtlindjet!
 Një pako ëndrrash,
 As magjia se zgjon natën nga dremitjet e portave.
 Aty njerëzit nuk kanë zë
 Qajnë e qeshin pavetëdije
 Natyra pëson lajthitjet e zakonshme,
 Vera është e bardhë,
 Dimri i kuq si petal trëndafili,
 Vjeshta ka vënë kujën jeshile,
 Pranvera gri si horizonti i syve pa jetë.
 Një tjetër vit ku zemra nis numërimi mbrapsht si
 Atëherë. . .
 Ky det pa anë me ngjyrë festash,
 Dekor i zi përhumur në zhurma kambanash.
 Ndahem në grima yjesh,
 Ka humbje të bukura!

Ennui

N'pragun tem, sorrë e zezë,
 ngulitun sytë, n'mue thellë
 hapun flatrat mbi kokën teme,
 hapun flatrat diçka ka ndez.
 Napër natë pluskon nì zá
 çjerrun, zbrazun gjumin tremb,
 çjerrun, zbrazun prap ndez dritën,
 krahët mbledh, trucesh dikun.
 Gjumit ikun dita vjen
 ti s'del ma po t'zezë na len
 po s'kish kanë faji yt,
 krahët e tuja s'kan mujt me majt
 tanë kët' mjegull që na ka mlù,
 tanë kët' tyl që n'dhé a shtru.
 Po ni sorrë ngulitun sytë,
 n'mue thellë, m'ka ngelë n'mend!
 S'di kujt fajin me ia lanë
 në t'zezn e saj a paska vend?!
 Sorrë e strukun, çjerrun, zbrazun,
 kush ta m'shon tanë kët' barrë?
 Zeza jote, dhimbja jonë?
 Katran ditë e katran varrë!
 Varrza, varrza zbrazun streht
 zbrazun sytë e zbrazun pémt
 ni gjethe tjetër u shkput e rá.

Tyl i zi na ka rrethu,
tyl që ne ta vumë ty,
a tyl që ti na e ke pru?
Çjerrun, zbrazun ditë që vjen,
çjerrun, zbrazun ditë ke shku!

Grimë çast

Drithërimë e athët dimri
 kurora të thyera lulësh përreth
 këmbë të ftohta akull, shkelin
 një pikë shiu, mbi sy, vrulltas godet
 shkundet qenia e kredhur në harresë,
 ecën sërish. . .
 Duron verbimin e së shtunës dritë
 në xhep gjej të humburën busull.
 Oh, jam prapë unë, këtu dhe atje.
 E rastisur.
 Në horizont shoh frymë pa kokë
 të huaj, me hijen e zezë ngjitur.
 Ecin për t'u kthyer apo në rrugë pa kthim?
 Po dyshoj për drejtimin e hapave të mi.
 Të shkretët, mbi baltë iu regjën plagët,
 po kthehem aty, ku më ngrohtë isha,
 me shpirtin e lodhur në krahë dhe të zbrazët.

Beniamin Shurdhi, 2017

Nën dritën e hanës

Nën dritën e hanës
Kërkoj t' lindi dielli,
Me trandjen e gjamës,
Pres t' hapet qielli.

Nën dritën e hanës,
Ulurijn' ulkonjat,
Nën terrin e natës,
Tremen dhe shqiponjat.

Nën dritën e hanës,
Lumejt' gurgullojn',
Pri shtratit t' nanës
Dalin dhe sulmojn'.

Nën dritën e hanës,
Po me at' zhurm,
Troku yt i kamës,
Largohet nga un.

Nën dritën e hanës,
Çudi! Gjarpnit flejn?!
Po n' mes t' lamës,
Lkurën bosh e lejn.

Nën dritën e hanës,
Shpresoj një jet' tjetër,
T' shpëtojm' pri dramës
T' mëkatit t' vjetër.

Lupa e shikimit të fajit

Pëshpërit,
Bardhësinë e ditëve që na gjetën
Përmendu
Stinë që shkoi lëri lamtumirën.
Këngëzën e nisur mos e braktis,
Këndoma përsëri.
Të kujtohem edhe unë, si ti
Se stinë e re erdhi,
Të kujtohem në ty se vonë
Pëshpërita në faj.
Kujtomë,
Kujtomë të derdh bojën deri në pikën e fundit,
Kujdesu,
Kujdesu që imi gabim mos të jetojë,
Flake në qytezën pranë.
Ndjeshmërisë i përkulem si sot,
Përhershëm,
Mbuluar në faj,
Fajin që zgjodha ta mbaj si e pafaj.
Ish ajo që deshën ata të gjithë,
U gjakosën për fajin që mbaj sot.
Zeher,
Zeher i ligsh të erdhi në mua e fjete gjatë.
Zgjomë,
Zgjomë e bindmë se ti shikon fajin,
E sheh nën veten time, hidhërueshëm

Bindmë se sheh pa lupë, uroj,
Lupa e shikimit të fajit nuk më njeh,
Ndaj mbylli më mirë qerpikët,
Ato kallëzojnë e përgjojnë
Qerpikë të pavënë në gjumë,
Lëri të përqafohen prej kohësh.

...

Në të pafajin qëllim,
Vetëzgjodha fajin e pavirtyt,
Atë faj që duhet ta shoh çdo ditë varur në qafë.
Po e ndih, ti hape qerpikun për një faj,
Imi faj që e ngjyrosa errët e ti më vjen me lupë,
Me lupë që t'i besosh qerpikut sprovë -
Lupën e shikimit të fajit, mbi supin tim...

Eja pranë!

Eja pranë!

Të shohim njëri-tjetrin në sy,

E të verbohemi nga një lumturi.

Nga një lumturi që veç unë e ti e dimë.

Eja pranë!

Të shohim gjethet e rrëzuara

Dhe siluetat e drurëve të zhveshur,

Që ngjyrosin mendjet tona në këtë kohë të zyrtë vjeshte.

Eja pranë!

Të ndjejmë ajrin që hyn egërsisht,

Nga dritarja e dhomës,

e ta mirëpresim e me ajër të ftohtë

Të veshim trupat tanë.

Eja pranë!

Të shohim një film të Tarkovskyit,

E shpirtrat tanë të ngrohim,

Oh, eja pranë!

Gjithë botën ta harrojmë

E asgjë përveç nesh

Të mos shikojmë.

Trupat

Trupat po ecin.
Ashtu të zhveshur,
Të qeshur,
Çaj në lëkurat e tyre,
I mbushin me lule të imta,
Me pupla të vjedhura nga kurma fazanësh,
Me flutura të thara
E pak ujë të ftohtë.
Trupat fillojnë derdhin
Nga buzët e ndyta
Mijëra fije flokësh
thonjtë
E gjak pa fund.
Trupat fluturojnë
Në thellësi të detit.
Në fletët e një shelgu
Qëndrojnë e mbillen.
Zhveshin lëkurat
Mishin,
Kockat,
Aromat e fluturave
kundërmojnë.

Toka e dashtun

Kamën teme që shkel n'kto troje
shum' e pate mârak...
shum' ke shpreh se doje
me ardh, me nejt veç pak.

Ke dasht me ngul shput' t'kams
n'kit vend që shpirtin larg s'ta ka,
ke dasht me bredh n'vendlindje t'babs
e plot bukurina syni me t'pa.

Nji kit' vend që t'fali kang't,
plisin n'kry edhe flamurin...
vend që s'mujte me i bredh an't
me fjalos n'tâ si burri me burrin!

Ty tash nuk t'dhimet ma loti jem
po m'dhimet mu tan' mishi jot,
lype tok'n me e shkel n'kam
po kjo tokë ty, t'paska dasht ma fort!

Pa titull

Përtej,
kur të vijnë e pafjala pranë meje
mes lulesh fshihmëni.
Të struken ëndrrat e mia.
Mos më zbuloni,
që kujtimi im
të mbërrijë mes të gjallësh
si dikur i gëzuar...

Më flisni,
që edhe unë të flas.
E derdha jetën...
Mbase s' do të më dëgjoni
në psherëtima mbytur.

Ndizeni
ndonjë cigare...
Tym të bëhet,
të mos shihet dhimbja
a buzagazi juaj...

Furizë

Kur furiza e jetës preku gjithësinë,
melodia e dhimbjes notonte në hapësirë.
Flokët e dëborës udhëtarit shpirtin ia mbuloi,
e në heshtje shumë fjalë pohoi.

Kur furiza e jetës lindi gjithësinë,
melodia e yjeve vallëzonte në hapësirë.
Flokët e dëborës shkallë-shkallë u shuan,
me bardhësinë e errësirës, gjithçka u zbukurua.

Kur furiza e jetës preku gjithësinë,
melodia e shpirtit fërshëlleu në hapësirë.
Flokët e dëborës shpejt vërshuan,
me shijen e akullt gjithçka u ngurtësua.

Mendohet njeriu

Mendohet njeriu e prej dritoreje hedh sytë mbi re,
për me gjet, ndoshta një atje, diçka të re!
Shpresa për të gjet diçka te re, e rren.
Atje ngul shikimin, e atje asgja s'gjen.

Në këtë lojë t'pashpirtshme,
Vritet!
Dhe po aty fuqinë e gjen
Dhe madhnisht, madhnisht ngadhënjën!

—●●● *Xhovana Gjergji, 2019*

Humnerë e bardhë

I zbrazun ky prag dëshirnash
Në shelg të k'rrusun rrahun shinash
Udha e lotit dredha-dredhna,
Lufton gjamën q'ndez heshtja
Mbytun thell n'oqean t'dunimit
Amëlsisht i vranë hidhnimi
Tinzash vjedhtik-tak-un netve t'dimnit.

Përshkrim

O natë. . . Më njëtrajtësohen mendimet me ty,
pikëllimet naive të plagëve, nisin korrin besnikërisht.
Kujtimet pikojnë në trajta prekjesh të njoma
e së bashku formojnë veç tinguj të ndryshkur.

Ty natë, të qofsha falë!
Mes puhizash trishtimi më diellon ndjenja,
fryma metamorfizohet në rënkime lutjesh,
e nisen drejt shtegut të qiellit.

Natë. . . jetojmë të dyja në simbioza morali,
unë të bëj shoqëri, ti më fal frymëzim.

Pa titull

Më kanë thënë
Se bora
Do të shtrojë sot...
Do të jetë ftohtë
Shkëndija do të dalin
Nga kërcunjtë
Në oxhak.
Aromë rrëshire
Do të rrëshqasë
Dhe do të dehë
Dhe borën
Dhe zjarrin
Dhe sytë
Me flakën
Do të flasë
Qetësi do të bëhet
Dhe...
Dhe...
Dhe...
Ah,
Kthehu!

PROZË

E vërteta që më zgjoi

Sapo u zgjova nga gjumi. E ndjeva që kisha bërë një gjumë jo të zakonshëm, si edhe ndihesha pak ndryshe nga ditët e tjera. Ndhesha më i lehtë dhe menjëherë ngrita kokën dhe shikimi shkoi te pasqyra. U shtanga. Pamja ime nuk dukej në pasqyrë. U afrova më pranë pasqyrës për të parë nëse ajo e kishte problemin apo unë nuk isha vendosur mirë drejt saj. Jo, nuk e kishte pasur fajin pasqyra, por kishte ndodhur diçka e pazakontë, isha shndërruar në një njeri të padukshëm. Por edhe pas kësaj përfundimi ishte i njëjtë, nuk isha më një njeri si gjithë të tjerët. Nuk e di a më besoni, por tani jam i padukshëm dhe për më tepër jam duke ecur nëpër kryeqytet, ose për të qenë më i sinqertë me ju dhe pa u mbajtur asnjë sekret, jam duke ecur nëpër Tiranë. Sapo arrita në sheshin “Skënderbej”. Askush nuk po më sheh. Për këtë gjë ndihem me fat, por edhe fatkeq njëkohësisht. Ndhem me fat se do t’ju tregoj të gjitha ato që shoh pa më vënë re askush, por ndihem edhe fatkeq, sepse nuk është e lehtë të lëvizësh pa tërhequr të paktën qoftë edhe një shikim. Zakonisht, kur jam i mërzitur, eci në qendër të Tiranës dhe sot po bëj të njëjtën. Arsyeja e vetme pse e bëj këtë gjë është e shpjgueshme dhe do të mundohem t’ju jap shpjegime. Aty ka një mrekulli, ku jo në çdo vend mund ta gjesh. Aty gërshetohen shumë botëkuptime, ideologji që u përkasin kohërave të ndryshme, por që i gjen në të tashmen të ndërthurura. Mund t’i shohësh dhe t’i prekësh në të tashmen, pasi ky qytet duket se i ruan aty, është mikpritës dhe tolerant. Nuk i tret në brendësi të tij, por i ruan të gjitha elementet tradicionale, moderne dhe postmoderne. Nëse këtë që po them nuk e besoni, më lini së paku të rrëfhem te ju. Tek e fundit, nuk dua t’i mbush mendjen askujt, por ajo që mund të bëj unë, në këtë gjendje që jam, është që së paku të rrëfej. E përsëris, jam një i padukshëm dhe më duhet të jem shumë i kujdesshëm në hapat që hedh, edhe pse jam pak i nervozuar. Në të

kundërt mund të lëviz diçka pa dashje dhe të gjithë këmbësorët do të tremben e do të shtypin njëri-tjetrin. Përpara statujës së Skënderbeut duket se qenkan shtruar disa tavolina të stërmbushura me njerëz të moshave të ndryshme. Në njëren tavolinë shoh dy të rinj, një vajzë rreth 19 vjeçe dhe një djalë rreth 22 vjeç, sa do të doja të isha në vendin e tyre, por jo të veproja si ata. Nuk janë duke biseduar me njëri-tjetrin, pasi kanë nxjerrë smartfonat dhe po lundrojnë në internet secili sipas qejfit të vet. Më mërziti kjo gjendje, desha t'i qortoj pak, por nuk mundem, sepse jam i padukshëm. U largova të hedh një sy nga tavolinat e tjera. Në njëren prej tyre sapo u ul një i moshuar rreth 80 vjeç, me një mjekër të thinjur, jo shumë të gjatë, dy burra me pamje serioze, të veshur me kostum e të mirëkollarisur.

Afër tyre u ul dhe një riosh rreth 25 vjeç. Kërkoj ndjesë nëse gaboj me pak vite në moshën e tyre, por po mundohem mos t'ju zhgënjeh. Po vdes nga kureshtja ta dëgjoj nga fillimi bisedën pa humbur kohë, pasi në të kundërt nuk kam sesi t'jua tregoj bisedën në gjysmë, pasi nuk do të kuptoni gjë. Në fillim pati heshtje, deri në momentin kur hoxha filloi të thërrasë Ezanin në minare dhe shumë afër xhamisë, pak më tej u dëgjuan kambanat e kishës. Pak më tutje, si për çudi, në të njëjtën kohë po zhvillohej një koncert me muzikë të lartë. S'kishte si të mos binte në sy zhvillimi i teknologjisë; një djalë qan hallet me një robot të kushtueshëm, i cili duket se e ka zërin në fund e duket sikur ha inat me muzikën, kush të tërheqë më shumë vëmendje.

Këta zëra erdhën njëherazi në tavolinën tonë, të njohur tashmë dhe shërbyen për hapjen e bisedës dhe thyerjen e bisedës shurdhuese. I moshuari me ballin me rrudha, flokë e mjekër të thinjur, fillon të flasë me një zë tërheqës, që më bëri me të parën për vete. Nga biseda kuptova se i moshuari quhej Xhemil, ndërsa i riu Gregor. Dy burrat e tjerë quheshin Ilir dhe Arbër.

I moshuari filloi të flasë:

- A keni menduar ndonjëherë për të vërtetën?
- Cila është e vërteta sipas jush?
- Çfarë keni menduar deri tani për të vërtetën?

Edhe unë pas këtij fjalimi fillova të mendoj, por të riut nuk iu prit dhe pa mbaruar të gjitha pyetjet, e ndërpreu të moshuarin duke folur me një zë paksa të lartë.

- E vërteta është subjektive. Fundja, kjo dihet dhe merret e mirëqenë. Nuk e kuptoj çfarë ka ngelur më këtu për t'u biseduar. Për mua e vërteta është ta shijoj jetën në çdo çast të saj, në të kundërt koha rrjedh pa dobi. Nuk më intereson e vërteta e tjetrit, por e respektoj atë në maksimum.

Ilirit dhe Arbrit nuk u pëlqeu kjo sjellje, por edhe mënyra e të arsyetuarit, ndoshta ngaqë i riu foli para tyre. Por mesa shoh përsëri kam të drejtë. Le të dëgjojmë se çfarë thotë Iliri:

- Në kohën tonë, kur ishim të rinj e respektonim më të madhin, qoftë edhe nëse diferencat e moshës ishin të vogla e jo më të ndërprisnim një të moshuar. Arbëri qeshi pak dhe kërkoi lejen e Ilirit për t'iu përgjigjur pyetjes së të moshuarit, i cili po e dëgjonte me kujdes. Pasi e miratoi Iliri me kokë, Arbëri filloi të flasë:

- Z. Xhemil, më mungon përvoja juaj dhe fjala që ju nxirrni ka me të vërtetë peshë. E kush nuk ka dëgjuar për ju dhe prirjet e tua se besoni te një e vërtetë hyjnore. Por, më lejoni t'ju them se për mua e vërteta hyjnore nuk është fort bindëse dhe e besueshme. Unë personalisht besoj tek e vërteta racionale, te shkenca dhe arsyeja e pastër. Hapat e mi janë të sigurt, kur unë eci me arsye. Kur udhëhiqem nga instinkti rrezikoj.

Xhemili i dëgjoji të tre me vëmendjen më të madhe. Përsëri filloi të fliste me një zë që dukej pak i zhgënjyer, që dukej se përcillte të njëjtat fjalë, por nuk shuhej asesi. Së pari, iu drejtua Ilirit dhe Arbrit duke iu thënë:

- Arsyeja është një armë e fortë, por që s'ka ku mbështetet. Nëse një veprim është i mirë ose i keq, arsyeja nuk e zgjidh gjithmonë. Më lejoni t'ju paraqes një shembull konkret që ka një përgjigje të madhe.

Nëse një shtëpi është duke u djegur dhe brenda saj ndodhet një i moshuar, arsyeja të thotë: "Nuk ia vlen të digjesh edhe ti me të". Ajo që të shtyn ta shpëtosh është ndërgjegjja dhe e vërteta, të cilat të kujtojnë se të shpëtosh një njeri ke shpëtuar të gjithë botën.

Më tej, ai vazhdoi të thotë:

- Shkenca dhe feja bashkëjetojnë me njëra- tjetrën. Feja na drejton tek e vërteta racionale dhe irracionale njëherazi. Njeriu ka nevojë për të dyja.

Sytë i ktheu nga i riu. Mesa dukej ai e kishte humbur durimin, sepse sapo kishte nxjerrë telefonin dhe po bisedonte në rrjete sociale. Ndoshta për të kjo bisedë ishte e tepërt. Iliri dhe Arbëri këmbëngulnin në të tyren dhe Arbëri e tha qartë mendimin e tij:

- Nuk besoj tek e vërteta hyjnore derisa të shoh Zotin me sytë e mi.

Nuk u besova veshëve, e kisha dëgjuar shumë herë këtë shprehje dhe menjëherë ia plasa të qeshurit. U dëgjua shumë. Fundja edhe unë isha i padukshëm për ta, por ekzistoj dhe isha pranë tyre, më afër se kurrë ndonjëherë, por ata nuk mundeshin të më shikonin. E qeshura ime u dëgjua në të gjithë sheshin, dhe pati reagime të ndryshme. I moshuari qeshi pas meje dhe iu drejtua bashkëfolësve:

- E shikoni! Në të vërtetë ka gjëra përtej nesh, në botën tonë të vogël, por jo të gjithë i pranojnë dhe kuptojnë ato. Disa kanë sy, por nuk shikojnë e disa të tjerë kanë veshë, por nuk dëgjojnë.

Dritaren e kisha harruar hapur. Disa pika shiu më kishin rënë në fytyrë. Më doli gjumi. E gjitha kishte qenë një ëndërr. Po mendoja rreth ëndrrës. A ishte ajo një ëndërr si gjithë të tjerat, apo ishte një sinjal i qartë se edhe unë duhet të mendoja për të vërtetën? Zakonisht, ardhja e gjumit i vë njerëzit të flenë, kurse mua më zgjoi!

Koha në gjilpërën prej pambuku...!

Unë kam një ëndërr. Ëndërr blu...! Koha në gjilpërën prej pambuku të jetë imja. Të jetë imja dhe shëtitja e fluturave, aroma e shiut, perëndimi i diellit dhe shkrepitja e shkurtit. Unë kam një ëndërr! Të qëndroj mbi flluskë...! Shkuma e sapunit të jetë imja...! Të jetë imja dhe flluska vetë. Të jetë imja dhe jetëgjatësia e flluskës...! Shiu i verës, kënga e gjelit dhe fytyra e shpirtit të sime mëje. Të jetë imja, vallja e yjeve, gurët e lumit, era e malit dhe shpirti blu. Unë kam një ëndërr, një ëndërr zgjuar. Portokalli të jetë katror, hëna të ketë fustan. Sytë të nuhasin, shpirti të ketë sy me qepalla të mëdha dhe mendja të ketë zemër trekëndëshi. Ajri të ketë ngjyrë, shiu të jetë jeshil dhe i nxehti të jetë i lëngshëm. Unë kam një ëndërr, të mos zgjohem. Të mos kem trup, vetëm shpirt. Të mos eci në tokë, vetëm në ajër. Të mos qaj, vetëm të qesh. Unë kam një ëndërr, ëndërr rrethore. Natyra të jetë imja, sendet mbajini ju. Dija të jetë imja, reklamën mbajeni ju. Paqja të jetë imja, zhurmën mbajeni ju, në mendje, në ëndrra, në tinguj dhe në kocka. Ah, por bota s'është imja. Ëndrrat, vetëm ëndrrat janë të miat, sukcesi është juaji...!

—●●— *Albina Rroshi, 2019*

Puhizë njerëzore

Nëpër shtigjet e jetës endemi me shpresa, përplasemi me mosrealizime, rrëzohemi me humbje, zvarritemi si statuja pa frymë që duam të ringrihemi për të thithur ajrin e realitetit. Të etur pas realitetit për të triumfuar, humbasim vetveten, lëvizim trarët e qetësisë sonë. Deri kur, kjo endje prej merimange të marrosur?! Në universin njerëzor sorollatemi në mes të zhurmave, të hapave të hedhur mbi rrugët e qytetit. Diku një buzëqeshje, diku një lot e diku tjetër një madhështi ndjesore përzier me mëshirë e frikë. Vallë, si humbasin njerëzit në tërë këtë gamë të madhe kuadrati universal?! Këto qenie të pajisura me frymë, me mend e me zemrën që pompon vendosin në lëvizje gjymtyrët e tyre. Vallë si i përdorin?! Diku, dikush do të humbasë në vorbullën e gjërave, për shkak të iluzioneve të pabaza jetësore. Në “modernen e së bukurës jetë” ngrihen ëndrra me ngjyra të kristalizuara në shpresë. Po deri kur zgjat kjo ëndërr se do të realizohet ai thelb i jetës sate?! Rrëmbimthi humbasim në monotoninë e ditës, në njerëz lajkatarë që të shohin si objekt pasurie, interesi të rrethuar me gjemba përkëdhelës hutohemi e i përqafojmë fort. E kështu kemi harruar veten, kemi harruar për frymën tonë se do jetë buzëqeshesh nga shpirti e jo kalimthi. Të mendosh se njerëzit humbasin në iluzione, apo në filtrin e imagjinatës do të ishte e pabazë. Pasi, medoemos njerëzit humbasin kur vetëm rreth tyre luhatet një melodi muzikore që të çon me adrenalinë në atë valle të padëshiruar. E mbase, të duket e këndshme e tërheqëse. Si një puhizë e ëmbël pranverore shfaqet uni lirik njerëzor, shpërthen në energji e me një kapërdimë të lehtë kalon në ekstazën vjeshtore, kjo energji laget nga shiu e qulloset deri në deje. Në këtë subjektivitet të ndërtuar nga fjalë të ëmbla shemben. Por, si?! Njerëzit humbasin nëpër termin “nuk bën kjo jetë për mua”, sapo t’i kafshojë apo t’i djegë diçka. Ndërkohë që harrojnë fare se shëndeti, të folurit, të dëgjuarit e

të ecurit janë begatia e tyre nga dhuratat e qenies njerëzore. Kështu, humbasin në atë labirintin e tyre. Vallë, pse kaq lehtë?! Njerëzit, qenie me intelekt e shpirt të dobët. Fortësia e tyre e veshur me mantel të pathyeshëm ka një maskë e hedhur syve, por muret e tyre të brendshme lëkunden nga frika e idesë së të ardhmes. Si do të jetë e ardhmja, kur pesimizmi i rrethanave e mbysin atë ambient të ndërtuar me forcë e mund deri tani?! Kështu pra, njerëzit humbasin nëpër dilemat e kësaj jete, lëkunden, rrëzohen e ringrihen sërish për t'u kënaqur me emocionet e pritshmërive jetësore. Se mbase e nesërmja do të jetë një kismet i ri! Për të mos humbur, duhet t'i bëjmë sytë katër, që gropat para e pas syve t'i vështrojmë e t'i kapërcejmë pa tërhequr vëmendje. Një hedhje pas krahëve është ideja më e lehtë që të mos humbasësh në të largëtën kohë, e të mos gërmosh në atë sëndukun e pluhurosur që godet si çekan nëpër trutë njerëzore. Për të mos humbur rrugën e duhur njerëzore, synimi i pranëvënë vetes të çon medoemos në destinacionin e një përralle të sakrifikuar.

Pnevamatoforë

Deti prapë. Deti ishte përherë aty. . . Këndonin sirenat. Melodi e trishtë dhe një gjendje e rëndë sëndisjeje zotëronte territorin e Poseidonit, si topitje dhe veselitje e athët.

Qëndronte ashtu këmbëkryq mes të kapilartave rrugë. Si një hon. . . Gati për të vënë distanca përherë e më të mëdha, kur ngjitazi ndihej një frymë e nxehtë e diafragma lëvizte në harmoni me ritmin paralel të jetës. Dhe ndoshta edhe qanim shoku-shoqin pa e parë, ndërsa dashuria na përgjonte pas supeve ose agonte dy herë pas muzgut ngjyrë jargavan të një filxhani çaji.

Nuk u kuptua aspak asgjë po thjesht ajo ndjesi ishte mbytëse. Ja tek po kalonte një prej atyre çasteve kur të gjitha ngjyrat zbeheshin, jeta bëhej e murrme dhe njeriu nuk kishte pikë force.

Ishte ajo zbatica mistike. Ajo pauza mes dy dihatjeve. Kafshimi i kohës që brente zemrën ngadalë. Ishte tamam ashtu sikur do të ecësh e s'mund të lëvizësh, kur do të flasësh po nuk ke zë. Era luante me vallen e ëndrrave, se ç'merrej me hapat, përmbysesj si hije për t'u lartësuar si konfuzion. Si ngaherë nën një mbetëz shiu, shtatore e bardhë fjetur në kopshtin e një ëndrre, me ftohtësinë e pasqyrës që parandien një krim. Erëhim ëmbëlçak që mendtë t'i merr fare. Vallë, pulëbardhat ku janë? Ç'thonë valët në gjuhë vajtimtare?

Deti prapë. Sa ia deshëm atë ngjyrë, atë pafundësi. Donim të ishim blu. Të ishim qielli që puthej me të horizonteve. Por në një kohë kozmike mbetëm në një sekuencë që s'bën as para as pas, e ethshëm kërkojmë shpëtim. Kur dora shtrihet dhe gishtërinjtë tentojnë një mpleksje bashkimi, uji joblu derdhet ashtu rrëshqitshëm e anëve të tij ngelen statikë, me shikimin poshtë e të dorëzuar dy ritme jete. Uji vazhdon të shpëlajë kasetat, ndoshta për t'i mbyllur rrugën fjalës. Lëngëzohet dhembja të cilën vullneti s'ka mundur ta gurëzojë. Se vegimet janë të shpejta në pamje, por të pavdekshme në kujtesë.

U hap pluhuri rreth e qark. . . mjegull. . .

Të ftohta bebëzat tentojnë të rigjejnë njëra-tjetrën, a thua se mund ta risjellin në jetë. Hutueshëm shquajnë dy flakë të bardha duke u ngritur përherë e më lart, që si në përrallat me Zana, e marrin shkëndijën prej shpirtrave “simbiotikë”. Se ne jemi shpirtbartës trima. E sa herë Mërkuri, Dielli e Marsi të jenë në vijë të drejtë kemi për t’u rigjetur në të eliksirtat galaksi.

Klepsidra

E hirtë lindi hëna. Unë fle duke ndjekur një këngë. Një këngë gjithë vaj, që me amzën e kohës që rrojmë është erëmuar. Jam një hije që banoj në hije dhe ushtar që luftoj kundër hijes. Kënga rrokulliset kalldrëmeve, shtigjeve përtokë. Gurth i përvuajtur i rrugëve që në ditë sfilitjesh kridhet në lymën e tokës. Ankthi çan udhë mes kockave, ngjitet nëpër damarë derisa shpërthen në lëkurë, në çurkaja ëndrre. E pret me ëndje një tjetër trup që ëndërron; Një gjysmë plus një gjysmë, Një ëndërr plus një ëndërr, figurëbarabartë, dashuribarabartë. . . Ecja ime në kohë vetëm këtë ndalesë paska. Te qiparis i ëndrës sate kalin zbres për të të parë. Një duhmë pluhuri vjen për të më shoqëruar në pafundësi. Dashuria që mbin në tokë nuk ikën kurrë me erën. Brenda një gjoksi vetmitar mbetet, e rritet së brendshmi pa pjalmim. Ja si bie pika e fundit që dridhet në Klepsidrën grykëhollë. Atje mes farfuritjesh pa kohë, një zemër Perëndie e pavdekshme rreh.

Tregoj

Kam fatin të jem një qenie me nivel inteligjence më të lartë se të tjerat, as qen, as zog, as peshk, por njeri... Nuk e di se ç'pasoje më ka krijuar! Evolucioni gjenetik nga majmuni? Kryqëzimi eksperimental midis jashtëtokësorëve dhe racave primitive? Apo Zoti, që pasi krijoi tokën, nga balta e saj më krijoi mua? Nuk më interesojnë shumë, pavarësisht se më pëlqen t'i trajtoj në mendjen time. E rëndësishme është që jam njeri! Nuk e di në erdhi Prometeu për të sjellë zjarrin tek unë, apo e krijova unë në mendjen time? E megjithatë, ka rëndësi që kam zjarrin. Dyshoj nëse zjarri është plotësisht i mirë a i keq? Është njëlloj si gota... gjysmëplot, apo gjysmëbosh? Por kryesorja është që dyshoj! Dyshimi tregon... Kërkoj të shoklavis gjysmëboshllëkun, apo gjysmëplotësinë! Vetësfidohem për të vetëtreguar! Sfidë vetjake, ose dy- a më shumëpalëshe, megjithatë mbetet dyshim me destinacion tregimin! Garoj me veten... Garoj me turmën... Kështu tregoj shumë... Në piramidën e vetes, maja e deritanishme. Në atë tjetrën, diku poshtë majës, por shumë larg bazës. Aty, lart janë ngjitur... larva që lëpjinë pështymën e tyre! E shikoni sa shumë tregon dyshimi... ? Në atë diku poshtë majës, hedh sytë mbi pamjen qesharake të bazës. Ja, atje... njerëz që ngrenë sytë lart dhe shikojnë në mua. Ç'pamje trishtazi qesharake ... më shohin e çuqurijnë vesh më vesh, përqeshin... çuqurimat dhe përqeshjet vijnë deri lart. Kështu veshi im i dëgjon. . . Megjithëse vrasin, nënqesh me ultësinë e tyre baltareske. Balta që hedhin, aq më bën! Mbushin grushtet nga dheu i pistë i mendjes së tyre, dhe bombardojnë karshi meje, karshi miqve të mi... baltë, baltë... ! Largësia midis meje dhe atyre është shumë e madhe! Gjynah ta krahasosh me distancën tokë-thua këmbë! Larvat janë shumë më të vogla se gishti! Sa shumë tregoj kështu... Në kavanozin e larvave, gjen lloj e soj! Praktikant, që ku-ku, nesër do të mësojnë fëmijën tim! Mësues minidiktatorë, përshtafës të mykësisë

mendore, në familje e shkollë, që sot mësojnë fëmijët e të tjerëve! Drejtor heterotrofe fjalimesh, që janë “yje” të hierarkisë së administratës. Bythëlëpirës pështirosës të kryetarit të partisë, që nesër bëhet kryeministër. Dhe këta i lyen, si mjeshtër piktoro-bojaxhi, me bojën karrem të propagandës! Gjithfarë sorrollopësh që s’kanë të sosur... Tregoj dita-ditës, që jam herëfish më i denjë se pseudopraktikanti, që, fatkeqësisht, nuk plotëson dot as ditarin. Zinxhirisht, që nuk është i aftë të diskutojë, a vlerësojë, një mendim, një shkrim ... asgjë! Dhe kështu, me injorancën e tij erëmbajtëse, krekoset qesharakisht. Po ashtu, që s’jam as bythëlëpirës, kësisoj gjendem pa pozitë, pa pushtet ... pa para të pista. Nuk jam as diktatori në shkollë, nëse zgjedh një karrierë të tillë. Njëjtësisht dhe në familje. Fatkeqësisht, fatmirësisht dua të them, jam ai që shikoj; shikohem, nënqesh; përqeshem nga poshtë. Jam njeriu ndryshe... Jam i paragjykuari!

Rrugënjë në perëndim

Qëndro, qëndro. Qofsh i lumtur gjithmonë duke parë këtë perëndim rrezatues që na fton të bëhemi pjesë e tij. Një qiell i pikturuar, si një telajo plot ngjyra. Shprehja e fytyrës tënde, sytë e ngulitur, ku gjej prehjen si një udhëtare e lodhur, nën hijen e pishave, në vapën e gushtit, ku freskia më vjen nga dallgët e shkumëzuara që përplasen në këmbët e mia.

Le të kënaqemi duke parë këto aureola drite, që pasqyrohen në këtë det që ngjan me një pasqyrë rrezellitëse.

Eja, eja ti o njeri të kridhesh në këtë det të pastër, që të ndiesh kënaqësitë e jetës, të largosh barrën e saj për një çast të vetëm, e të kuptosh se jeton. Dua që në sytë e tu, të shoh ëmbëlsinë, dashurinë, shkëlqimin që mos të venitet kurrë.

E shikon? Këtë perëndim të bukur që duket sikur është krijuar për ne, detin dhe qiellin e skuqur, filladin e lehtë që tund gjethet e pemëve e përkëdhel flokët tanë pa pushim.

Ti qëndron i qetë, pa ndonjë dredhje mbi atë fytyrë; asnjë brengë s'dukesh që pasqyron. Ndonjëherë një zë i brendshëm, thërret lulen e bukur që ndrin në rrezet e diellit, e fton me aq guxim drejt një udhëtimi të gjatë, në rrugënjën e pafund të jetës.

Kam frikë. . .

Duke ecur nëpër shkretëtirën e gjetheve vjeshtore, fillova të rënkoj. Rënkova thellë në shpirt për fatin tim. Mos vallë shpresën do ta gjeja në rënkim?!

Nëpër hapësirën vetmitare fillova të hidhja ca hapa kuturimthi. Dëgjova frymëmarrjen time që gulçonte nga një brengë e heshtur që fshihej nga turpi. E ndodhur mes stinës vjeshtore, vendosa trupin mbi këmbët e ngurta. I drejtova duart drejt pafundësisë si lisi i vetmuar që i shtrin degët e thyera e të zhveshura drejt stuhisë që po afrohet. U lodha nga ecja e mendimeve që po më bëheshin shoqëruese e vetmisë sime. Rënkim pas rënkimi, lodhje pas lodhjeje, unë dështova. Kisha ditë, muaj e gati dy vite, që po i kushtoja vëmendje që do më çonte në një destinacion të lumtur. Me këtë nismë, do të ndryshoja fatin tim, fatin e prindërve të mi. Por, jo! Iu ktheva sërish normalitetit, u shkëputa nga dëshira për të realizuar atë ëndërr. Tashmë e kam futur në një sirtar e po bën një gjumë dimëror. Ndoshta, do të vijë pranvera e do ta zgjojë atë. E di, ndonjëherë përpiqem të planifikoj jetën, por hezitohet e sërish kam frikë. Dëgjoj shumë fjalë egërsuese çdo ditë, si bie fjala se një vajzë e një krahine provinciale nuk mund të ndryshojë fatin e saj. Fshatarja është e detyruar të veshë petkun e saj nusëror e t'i nënshtrohet forcës burrërore. Por vallë, erdha në këtë jetë të veproj ashtu si të tjerët duan?! Pastaj, edhe unë jam krijesë që po i nënshtrohem fatit tim. Dua të jetoj, ndonjëherë, shpërthej me këtë dëshirë. Filloj të guxoj, ashtu si merimanga që nuk lodhet duke endur pëlhurën e saj të prishur edhe unë përpiqem të ndërtoj ëndrrën që dështoi. Por, sërish kam frikë. Fjalët e njerëzve, mosbesimi i tyre më prangos duart pas një prange të ftohtë. Fjalët e tyre të përditshme janë si ato pikat e shiut që kur përzihen me detin, bëhen pjesë e uraganit të tmerrshëm që shkatërron shkëmbinjtë nga themeli dhe gëlltit flota të tëra që udhëtojnë. E njëra prej atyre flotave jam unë, që dridhem nga

frika se mos rryma më rrëmben e më shpie në një tjetër anë të panjohur. E për të lundruar qetë duhet të kem një krah mbështetës në këtë udhë, pasi ashtu si nuk mund të duartrokasësh me njërën dorë, nuk mundesh të lundrosh pa një pikë mbështetjeje. Kjo pra, frika është një element që mundohet të triumfojë, por do të guxoj që ajo të mos triumfojë. Triumfuese do të jem vetë unë e jo frika. Unë do të vij ashtu si dielli i korrikut që do të ngroh borën e dhjetorit. Kisha frikë, kam ende ca grimca frike, por nesër s' do të ketë frikë. Pasi, shpirti im ka ëndrra e do të guxojë të jetojë, sepse nuk i dihet, një dorë e dytë mund të jetë shpëtimi im.

Fragment

Sipër një moment bëhet e mjegullt gjithçka? . . . Ajri i pamjaftueshëm. Ku shkoi ai? Endet nëpër rrugë që ndriçohen nga dritat po zhurmat nuk i ndien. Ka dal ashtu, po vrapon dhe diçka i ndalon frymën, i largon ajrin dhe ia mbush sytë me lëngun ndërparamës. S'merr dot frymë. Në buzët e përvuajtura dallohet dridhja. . .

“Edhe pak. . . duro se vajtëm. . .”

Refreni i zërit të saj e mbajti në këmbë. . . U zbeh në fytyrë, u këput nga dhimbjet, nga mungesa e ajrit, nga zhurmat e padëgjua dhe zemra sikur u lodh së vrapuari pas saj.

“Mbahu edhe pak. . .” Zëri i lëmekur i vinte nga largësia ngjitur me të. Asaj i dukej se ajo belbëzonte, vinte buzën në gaz nga merak, po zemra e mendja vuante së bashku me të. Ah, sa afër dhe larg ishin ato të dyja! Si mund të mos e kapnin ajrin? Mos vallë ishte në hapësirë apo hapësira i kishte vizituar shpirtin? Rrahjet po e godisnin fort dhe pulsi s'po ndihej. . . Ajo e shihte e shqetësuar. Fjalët përsëriteshin “S'arrij të marr dot frymë!”. Ishte zhytur në akull e vendi tundej nga ethet. Ajo i lëmonte fytyrën, diçka i pëshpëriste, po tjetra e kishte humbur. U deshën dy substanca të vogla të përziera së bashku, që ta kthenin sërish këtu, t'i sillnin atë që po kërkonte, ajrin. Ishte mpirë i gjithë kraharori dhe ajo vazhdonte të lutej për të. Përpëlitej nga rrahjet, nga shqetësimi dhe nga i ftohti. Sikur po ndiente diçka, sikur e ndiente ajrin që po i drejtohej, por e dinte që ai nuk ishte i mjaftueshëm.

Duhet të mbushej me ajër. . . Ç'ishte kjo kozmogoni ngjyrash e ndjesish të errëta që e kishin sjellë deri këtu? Po sikur ajri të kishte dashur të luante me të?

Sa pyetje të ajërta. . .

Ajo i zgjati dorën, i dhuroi një buzëqeshje paqësore, i shtrëngoi krahun dhe e shoqëroi të dilte. Jashtë u takua me ajrin. Ecte sa andejkëndeje dhe vazhdonte të thoshte se ende s'merrte dot frymë. E si nuk i dhuronte dot pak ajër ajo natë e qetë? Ndoshta edhe natës i pëlqente që ajo të endej për të gjetur ajrin, për të frymuar.

Akujt i kishin mpirë këmbët po ajo s'ndiente gjë tjetër, s'kërkonte gjë veç tij. Zëri i saj e solli sërish në dhomën e vogël, që mbante të gjysmuar një pjesë të ajrit.

Ajo u shtri, i shtrëngoi dorën asaj dhe vuajti në errësirën e natës mungesën e ajrit, që po kërkonte ngado.

Thërras fluturat

Vendi ku ndodhem më jep ndjesinë e të qenit mbi gjithçka, mbi tokë, mbi bimë, mbi gjallesat edhe mbi vetë njerëzit. Tej në horizontin e paanë shihet çdo gjë, pemët, lulet, bari, kodrinat, njerëzit, madje edhe uji i hidhur i detit.

Ka diçka që e thërras, e kërkoj ngado, por më kot, asgjë nuk duket. Fluturat! Kur isha fëmijë rendja pas tyre, e sot, as në ëndërr nuk më dalin. Kam dëshirën e zjarrtë për t'i ndjekur e ledhatuar! Nëse do të kisha flutura në zemrën time do t'i ndieja patjetër, në këtë mënyrë do ta shuaja gjysmën e mallit, por as këto nuk i ndiej dot.

Mjafton një flutur! Edhe një e vetme! Një fluturzë e vogël! Për ta bërë zemrën time që të ziejë nga dashuria. Ndoshta nuk është! Ndoshta nuk ka ardhur çasti! As personi ndoshta?! Syçelëta e zemrës sime! Ku të jetë vallë?

Ah! Ai miku! Dikur ai miku që e urrente dashurinë e më këshillonte që të mos bie në vorbullën e ndjenjave kontrolluese. Dhe ku ndodhet ai sot? Po mbytet në mesin e kësaj vorbulle, po lufton me këtë furtunë të pandalshme. Eh, miku im! Pse më jep këshilla pa kuptim?

Për çudi sot ende pres. Apo, mos vallë, fluturat e dashurisë nuk janë për mua? Apo unë siç ndihem i lartë mbi këtë kodër, e ndiej veten të paarritshëm? Edhe pse e di shumë mirë që fluturat e të tjerëve, janë në kërkim të fluturave të mia, që as unë vetë ende nuk i kam gjetur. Për këtë jam i vetëdijshëm, sepse ky mall thyen edhe qiejt edhe lulet i vyshk. Fluturat e një njeriu nuk mjaftojnë për dy persona. Qielli i shtatë arrihet me fluturat e dy njerëzve të dashuruar. Për ndryshe mbetesh në mes të rrugës.

Gjithsesi portat e zemrës sime janë të hapura për gjithkënd, por një dry hapet vetëm nga një çelës. Dhe atë e hap vetëm ai i duhuri. Sërish unë jam në pritje, shpresat më mbajnë, që edhe unë një ditë do t'i lumturohem takimit me fluturat e mia!

Ah, sikur!

Sikur. . . Çdo gjë nis me një “sukur” për të përfunduar në një “asgjë” të madhe. Jeta është vetëm një pikëpyetje ku ti mbetesh të jesh pyetja në pamundësi për të qenë një pikë në fund të kapitullit tënd. Në kafshatën e fatit një “sukur” e mbytur dëgjohet në çdo përplasje dhëmbësh, në çdo frymë të dalë nga nevoja për mbijetesë. Ah! Sikur! Në atë trepikëshin e kësaj fjale, në atë presjen për të nisur aty ku e le në lidhje me atë çfarë ti kishe nisur. Ti hesht, zgjedh të heshtësh duke mbyllur sytë edhe pse me kokën lart që vendin t’ia lëshosh dikujt si ti, një tjetër kalimtar i zëvendësueshëm, por në të njëjtën rrugë. . . Në çdo tingull të një kitareje të shurdhët dhe rënkuese, ti le gjurmën tënde dhe ajo nuk është gjë tjetër më shumë se një jetë. E keni provuar ndonjëherë të dëgjoni një “tik-tak” në një dhomë të vjetër, por me dritare të mëdha? E keni provuar ndonjëherë ndjesinë e të qenit “unë” kur kjo botë është e mbushur me “ne”, me “ata” me uniforma të njëjta? Nëse një ditë zëri do të të kumbojë në boshllëkun e mbushur nga ajo “sukur”, bërtit akoma më fort, ndoshta për të zgjuar veten dhe për të kuptuar që asgjë në jetën tënde nuk ka vend për një “sukur”. . . Ah, sikur, unë të isha një i tillë!!

PËRMBAJTJA

PARAFJALË

<i>Lili Sula</i>	1
<i>Viola Isufaj</i>	2
<i>Belfiore Qose</i>	3


POEZI

<i>Anxhela Lepuri</i>	Firë	5
<i>Parajsa Shtini</i>	Jeromë	7
<i>Lavdie Bakiu</i>	Rranja (Monolog i nji njeriu t'papërsosun)	8
<i>Vjola Aliaj</i>	***	9
	Boll ma	10
<i>Xheni Kapllani</i>	Dy ditë	11
<i>Eqerem Torra</i>	Si gruri do të digjem fushës	12
<i>Ariela Shehu</i>	Porositë e Gjyshes	13
<i>Barbara Molla</i>	Gri	15
<i>Stela Palushi</i>	Rreth yjeve	16
<i>Gela Çuçka</i>	Më duhet të iki	17
<i>Arben Krasniqi</i>	Ti, pastaj unë	18
<i>Egla Xhemali</i>	Net Krishtlindjesh	20
<i>Angjela Marku</i>	Ennui	21
<i>Eva Kasëmi</i>	Grimë çast	23
<i>Beniamin Shurdhi</i>	Nën dritën e hanës	24

<i>Flutura Kamberi</i>	Lupa e shikimit të fajit	25
<i>Kristi Sejdi</i>	Eja pranë!	27
<i>Xhensila Buba</i>	Trupat	28
<i>Xhesika Gjeçi</i>	Toka e dashtun	29
<i>Servet Kasollja</i>	Pa titull	30
<i>Sonila Çullhaj</i>	Furizë	31
<i>Engjëll Luçi</i>	Mendohet njeriu	32
<i>Xhovana Gjergji</i>	Humnerë e bardhë	33
<i>Mersina Makollari</i>	Përshkrim	34
<i>Rileda Mero</i>	Pa titull	35

PROZË

<i>Irdi Bardhi</i>	E vërteta që më zgjoi	37
<i>Matilda Miraka</i>	Koha në gjilpërën prej pambuku	41
<i>Albina Rroshi</i>	Puhizë njerëzore	42
<i>Esma Dodaj</i>	Pnevamatoforë	44
	Klepsidra	46
<i>Engjëll Luçi</i>	Tregoj	47
<i>Rolinda Murati</i>	Rrugënajë në perëndim	49
<i>Albina Rroshi</i>	Kam frikë	50
<i>Egla Xhemali</i>	Fragment	52
<i>Ramazan Lloti</i>	Thërras fluturat	54
<i>Artiola Ndoj</i>	Ah, sikur!	56



Një botim që përshfaq shpirtin krijues të studentëve në komunikim artistik të përbashkët, si dëshmi e përvojë e kreativitetit dhe talentit të tyre e si pjesë e traditës së studentëve të Degës së Gjuhës e të Letërsisë Shqipe, të Universitetit të Tiranës, prej të cilëve kanë spikatur personalitete të dijes albanologjike e shkrimtarë e poetë të shquar.

*Prof.asoc.dr. Lili Sula,
përgjegjëse e Departamentit të Letërsisë*

Studentët tanë vijnë këtu me të tilla përpjekje për komunikime, dhënie dhe marrje me enigmen e poezisë – përfaqësuar nga krijimet me të cilat morën pjesë në festivalet që organizon Departamenti ynë, më 23 Prill. Shí në këtë rrethanë dramatike dhe surreale të kaplimit të botës nga një epidemi, janë tridhjetë e shtatë gjuhë shpirtrash që na përshëndesin sot; e pa asnjë dyshim, në çdo kohë e rrethanë letërsia flet...

Prof.asoc.dr. Viola Isufaj

Botimi i kësaj përmbledhjeje është një rast për të cilin gëzohemi si profesorë të tyre, por edhe si krijues, pasi e njohim emocionin e publikimeve të hershme. Ne jemi të bindur se në këtë botim ka krijues, emrat e të cilëve në të ardhmen do të jenë ndër autorët më të mirë të letërsisë shqipe.

Dr. Belfjore Qose